



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/254
Datë: 26.03.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

- Themelohet Këshilli Organizativ për shënimin e 12 (dymbëdhjetë) qershorit, Ditës së Çlirimit të Kosovës, në këtë përbërje:
 - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryesues;
 - Ministri i Mbrojtjes, anëtar;
 - Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtare;
 - Ministrja e Drejtësisë, anëtare;
 - Ministri i Punëve të Brendshme, anëtar;
 - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar; dhe
 - Përfaqësues, Zyra e Kryeministrit, anëtar.
- Ftohen që të dërgojnë nga një përfaqësues në Këshill:
 - Përfaqësues, Zyra e Presidentes, anëtar;
 - Përfaqësues, Kuvendi i Republikës së Kosovës, anëtar;
 - Përfaqësues, Komuna e Prishtinës, anëtar;
 - Komandanti i Forcës së Sigurisë, anëtar;
 - Kryetarët e Organizatave të dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar;
 - Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, anëtar;
 - Përfaqësues i Familjes Jashari, anëtar; dhe
 - Përfaqësues të OJQ-ve.
- Me kërkesë të Kryesuesit të Këshillit Organizativ, mund të themelohen nën-grupe për realizimin e aktiviteteve sipas nevojave të Këshillit Organizativ.
- Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Këshilli Organizativ për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/254
Datë: 26.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 16 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Ridvan Hoti emërohet në pozitën e Zëvendësdrejtorit Ekzekutiv për Trajtim të Burgosurve në Shërbimin Korrektues të Kosovës.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendim zgjat katër (4) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/254
Datë: 26.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 16 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Irfan Lipovica emërohet në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi zgjat katër (4) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/254
Datë: 26.03.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohen analizat juridike për thjeshtimin e lejeve dhe licencave të lëshuara në kuadër të Autoritetit të Aviacionit Civil, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Autoritetit të Hekurudhave të Kosovës, Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit, Komisionit të Pavarur për Media dhe Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë, që në pajtim me fushën e përgjegjësisë së tyre administrative të iniciojnë procedurën e ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve të parapara në analizat juridike për thjeshtimin, bashkimin ose eliminimin e lejeve dhe licencave.
3. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit, që në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, të koordinojë procesin e implementimit të analizave juridike për thjeshtimin, bashkimin ose eliminimin e lejeve dhe licencave të miratuara me këtë Vendim.
4. Udhëzohen institucionet nga pika 1 e këtij Vendimi që t'i zbatojnë rekomandimet e analizave.
5. Pjesë e këtij Vendimi janë Shtojcat e analizave juridike për thjeshtimin e lejeve dhe licencave të lëshuara në kuadër të Autoritetit të Aviacionit Civil, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Autoritetit të Hekurudhave të Kosovës, Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit, Komisionit të Pavarur për Media dhe Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/254
Datë: 26.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 39 dhe 45 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 mars 2025, merr këtë:


V E N D I M

Për Anulimin e pjesshëm të Vendimit Përfundimtar Nr.06/98 të datës 18 prill 2019

1. Anulohen nga Vendimi Përfundimtar Nr.06/98 të datës 18 prill 2019, parcelat si më poshtë:
 - Parcela Nr.541-1 e paraqitur në rreshtin Nr.17 tabela për zona kadastrale Gjilan, Komuna Gjilan;
 - Parcela Nr.541-2 e paraqitur në rreshtin Nr.24 tabela për zona kadastrale Gjilan, Komuna Gjilan;
 - Parcela Nr.557-14 e paraqitur në rreshtin Nr.14 tabela për zona kadastrale Gjilan, Komuna Gjilan;
 - Parcela Nr.557-15 e paraqitur në rreshtin Nr.11 tabela për zona kadastrale Gjilan, Komuna Gjilan;
 - Parcela Nr.558-2 e paraqitur në rreshtin Nr.7 tabela për zona kadastrale Gjilan, Komuna Gjilan;
 - Parcela Nr.558-3 e paraqitur në rreshtin Nr.8 tabela për zona kadastrale Gjilan, Komuna Gjilan;
 - Parcela Nr.558-15 e paraqitur në rreshtin Nr.9 tabela për zona kadastrale Gjilan, Komuna Gjilan.
2. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPHI ia dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e këtij Vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPHI bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/254
Datë: 26.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 12, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, të Ligjit Nr. 08/L-067 për Inspektimet, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Përgjithshëm Vjetor mbi Inspektimet.
2. Raporti i Përgjithshëm Vjetor mbi Inspektimet, nga pika 1. e këtij Vendimi, publikohet në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm.
3. Obligohet Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për zbatimin e pikës 2. të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/254
Datë: 26.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 18, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08/L-067 për Inspektimet, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzuesi për Inspektimet e Përbashkëta.
2. Udhëzuesi për Inspektimet e Përbashkëta, nga pika 1. e këtij Vendimi, publikohet në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm.
3. Obligohet Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për zbatimin e pikës 2. të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/254
Datë: 26.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

- Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. paragrafi 1.1. i Vendimit të Qeverisë Nr. 11/253 të datës 21 mars 2025 për Emërimin e Komisionit Ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitat e Kategorisë së Lartë Drejtuese: Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Kosovës për Administratë Publike, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Regjistrimit Civil, Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë për Siguri Kibernetike dhe Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, si në vijim:
 - Lumnije Demi, Drejtore e Përgjithshme në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, kryesuese.
- Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 11/253 të datës 21 mars 2025.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë